FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

**VENDIMET E BORDIT TË FBK-së TË DATËS 18.04.2016**

Bordi i Federatës së Basketbollit në mbledhjen e vet të mbajtur më 18.04 2016 ndër të tjera miratoi edhe këto

**VENDIME**

1. Bordi emëroi përzgjedhësit e reprezentacioneve të kategorive të reja që sivjet garojnë në kampionate përkatëse evropiane dhe emëroi udhëheqësit e delegacioneve përkatëse në kampionate.

Reprezentacioni U16 - Kampionati Evropian U 16, Divizioni B, Bullgari:

Përzgjedhës: Chris Dial

Udhëheqës të delegacionit: Leart Hoxha, Besim Braha

Reprezentacioni U18 – Kampionati Evropian U 18, Divizioni C, San Marino:

Përzgjedhës: Dritëro Sefaja

Udhëheqës të delegacionit: Linda Shala, Arben Fondaj

Reprezentacioni U20 - Kampionati Evropian U 20, Divizioni C, Greqi:

Përzgjedhës: Ilir Selmani

Udhëheqës të delegacionit: Leart Hoxha, Shaqir Totaj

Reprezentacioni U16F - Kampionati Evropian U 16F, Divizioni C, Andorra:

Përzgjedhës: Fidan Shatri

Udhëheqës të delegacionit: Learta Berisha, Mentor Rruka

Reprezentacioni U18F, Kampionati Evropian U 18F, Divizioni C, Gjeorgji:

Përzgjedhës: Chris Dial

Udhëheqës të delegacionit: Valdet Spahija, Elvira Dushku



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

2. Bordi u njoftua për aranzhimet e ndeshjeve miqësore dhe aktiviteteve verore të reprezentacionit A dhe planin financiar të aktiviteteve verore të reprezentacionit.

3. Bordi u informua për negociatat konkrete që janë zhvilluar për të drejtat televizive për reprezentacione dhe inkurajoi Kryetarin e FBK-së të vazhdojë me negociata dhe të informojë Bordin me rastin e arritjes së marrëveshjes përfundimtare.

4. Bordi u informua për zhvillimet e fundit në raport klubet e Kosovës – FIBA dhe shprehi vendosmëri për zbatim të vendimeve të FIBA-s që kanë të bëjnë me klubet e Kosovës.

5. Bordi shqyrtoi situatën aktuale në segmentin e referimit me theks të veçantë në periudhën pas Turneut Final të IPKO Kupës dhe para fillimit të plejofit të Superligës. Bordi autorizoi Sekretarin e Përgjithshëm që të kontaktojë me klubet që të deklarohen nëse janë pro angazhimit të një gjyqtari të huaj në ndeshjet e plejofit. Bordi po ashtu vendosi që ndeshjet finale të Ligës së Parë të gjykohen nga tre gjyqtarë.

6. Bordi u informua për përpilimin e letrave të zotimit që u janë dërguar basketbollistëve potenciale për reprezentacionin A dhe lojtarët që deri në këtë periudhë janë kontaktuar për mundësinë e paraqitjes për reprezentacionin A.

Erolld Belegu

______________

Kryetar, Federta e Basketbollit e Kosovës

Kosovo Basketball Federation, Lagjja Arbëria, Objekti C2/11, Lokali nr. 4, 10000, Prishtina, Kosovo
ëëë.basketbolli.com, email: info@basketbolli.com, tel: +381 38 704 101; mob: +386 49 738 080

REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT